

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosova



Shoqata e Gjykatësve të Kosovës
Kosovo Judges Association
Udruženje Sudija Kosova



Oda e Avokatëve të Kosovës
Kosova Chamber of Advocates
Advokatska Komora Kosova



Shoqata e Prokurorve të Kosovës
Kosovo Public Prosecutors Association
Udruženje Javnih Tuzivlaca Kosova

MEMORANDUM

BASHKËPUNIMI

PRISHTINË
Korrik 2009

Oda e Avokatëve të Kosovës, Shoqata e Prokurorëve të Kosovës dhe Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës, në Prishtinë, me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit afatgjatë, lidhin këtë

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

A. FORMATE BASHKËPUNIMIT:

I.

Palët në këtë Memorandum: Oda e Avokatëve të Kosovës [më tutje "OAK"], Shoqata e Prokurorëve të Kosovës [më tutje "SHPK"] dhe Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës, [më tutje "SHGJK"] do të zhvillojnë format e bashkëpunimit në fushëveprimin e vet.

Për këtë qëllim ata do të ndërtojnë lidhje të qëndrueshme në shkëmbimin e ekspertizës, përvojës dhe resurseve.

II.

Palët do të mbështesin bashkëpunimin reciprok, do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta dhe bashkarisht do të realizojnë bashkëpunimin nga fusha e këtij Memorandumi.

III.

Palët gjithashtu do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta me qëllim të forcimit të besimit të komunitetit në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Veçanërisht do të inkurajohet bashkëpunimi i ndërsjellë në fushën e trajnimeve dhe zgjidhjes së problemeve nga fusha e gjyqësisë, prokurorisë dhe avokatisë, si dhe në aspektin e respektimit të të drejtave të njeriut.

OAK, SHPK dhe SHGJK pajtohen në realizimin e ndërtimit të praktikave të qëndrueshme në forcimin e ligjit, duke organizuar tryeza të përbashkëta nga etika profesionale dhe fushat tjera.

IV.

Në mënyrë specifike palët merren vesh për bashkëpunim në këto fusha:

1. Tryeza të përbashkëta debati, për angazhimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare dhe pozitave në procedurën penale;
2. Takim-shoqërimi mes anëtarëve të OAK, SHPK dhe SHGJK / Bench Bar;
3. Tryeza debate për praktikën gjyqësore - shqetësimet e profesionit;
4. Module të përbashkëta për etikën profesionale;
5. Nxitja e paraqitjes së anëtarëve të paleve në publikime në buletinet perkatëse me qëllim të nxitjes së shkrimit ligjor dhe praktikave gjyqësore;
6. Përfshirja e ekspertëve për programet për mentorimin e gjeneratave / PggP dhe për AVL për avokatët e rinj.
7. Realizimi i Programeve të përbashkëta për vetëdijësimin ligjor të komunitetit
8. Promovimi i praktikave të mira gjyqësore, pranimi i fajësisë.

B. IMPLEMENTIMI:

I.

Ky Memorandum fillon të implementohet nga palët nënshkruese në ditën e nënshkrimit.

II.

Palët do të caktojnë nga një përfaqësues edhe atë nga OAK-Sekretaren e Odës, nga SHPK-administratorin e PPK dhe nga SHGJK - koordinatoren, që në periudhën e parë të bashkëpunimit-gjashtë(6) mujore, të analizojnë ecurinë e këtij bashkëpunimi.

C. NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI:

I.

Memorandumi hyn në fuqi dhe i obligon palët në momentin e nënshkrimit nga palët.

II.

Palët detyrohen t'i përmbushin obligimet që dalin nga ky Memorandum.


III.

Memorandumi është i përpiluar në tre ekzemplarë me përmbajtje të njëjtë, prej të cilëve, pas nënshkrimit dhe protokolimit, nga një ekzemplar do t'i mbetet secilës palë.

IV.

Me autorizim që të pranojnë përgjegjësitë dhe të nënshkruajnë këtë Memorandum.


Në emër të:
Odës së Avokatëve të Kosovës,


Musa Xh. Dragusha, Kryetar

Në emër të:
Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës


Ymer Huruglica, Kryetar

Në emër të:
Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës


Ismet Kabashi, Kryetar

Nënshkruar në Prishtinë,

Datë: 13.07.2009